

Një numër
telefoni
për të gjithë
fëmijët



alo 116
TELEFONI I NDIHMËS PËR FËMIJËT
ALBANIAN NATIONAL CHILD HELPLINE

alo 116111
LINJA PAN-EUROPIANE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI
ALBANIAN PAN-EUROPEAN CHILD HELPLINE

alo 116000
LINJA PËR FËMIJËT E HUMBUR NË SHQIPËRI
ALBANIAN NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

ALO 116: Kur një fëmijë telefonon, ne përgjigjemi gjithmonë!

ALO 116 – Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë është një shërbim pa pagesë për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në të gjithë Shqipërinë, 24 orë çdo ditë të javës. ALO 116 u lançua zyrtarisht në 1 qershor 2009. ALO 116 pret mesatarisht 400 telefonata në ditë. Gjatë këtyre 4 viteve ALO 116 ka pritur më shumë se 477,066 telefonata nga të cilat janë trajtuar 12 351 çështje.

UNICEF në Shqipëri dhe Linja Ndërkombëtare e Këshillimit për Fëmijë kanë patur një bashkëpunim intensiv në ndërtimin dhe konsolidimin e ALO 116-Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë në Shqipëri. Në vitin 2008 UNICEF ka punuar me ekspertë të CHI-së për të përgatitur bazën e ndërtimit të ALO 116. Me 1 qershor 2009 UNICEF dhe partneri i tyre lokal në Shqipëri CRCA zyrtarisht lançuan ALO 116 falë eksperiencës dhe ekspertizës së ofruar nga CHI si binjakëzimi i ALO 116 me organizatën Buzëqeshja e Fëmijës në Greqi dhe ekspertizën për trajnimin e ekspertëve dhe këshilluesve të ALO 116. Për të ruajtur dhe forcuar cilësinë e shërbimit për fëmijët në Shqipëri përmes ALO 116, UNICEF ka mbështetur fuqimisht ALO 116 në procesin e antarësimit me të drejta të plota në Linjën Ndërkombëtare të Këshillimit për Fëmijë (CHI)

si një mundësi për të sjellë zërin e fëmijëve shqiptarë sëbashku me zërin e fëmijëve nga Europa dhe bota. Me 19 tetor 2012, ALO 116 u bë anëtare me të drejta të plota e Linjës Ndërkombëtare të Këshillimit për Fëmijë.

ALO 116-Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë është shembull kryesor i një praktike të mirë të mënyrës se si UNICEF, organizatat e shoqërisë civile, autoritetet publike dhe sektori i biznesit bëhen sëbashku me qëllim ofrimin e ndihmës për çdo fëmijë në rrezik dhe që ka nevojë për mbrotje. UNICEF së bashku me partnerin lokal CRCA Shqipëri kanë ndërtuar dhe lehtësuar procesin ku ALO 116 shikohet si një model i mbrotjes së fëmijëve, referimit dhe koordinimit, është mbështetur nga autoritete kombëtare për të tejkaluar pengesat teknike dhe praktike, ndërkohë që të gjitha kompanitë e telefonisë celulare dhe fikse vijnë së bashku për të siguruar telefonata pa pagesë për fëmijët drejt ALO 116. Ky lloj i partneritetit, ku të gjithë partnerët nga sektorët e ndryshëm bëhen së bashku për të mbrojtur fëmijët është shembulli më i mirë se si shoqëria duhet të përgjigjet ndaj nevojave të fëmijëve.





Shqetësimet kryesore të raportuara nga fëmijët pranë ALO 116 janë: **513** çështje të abuzimit fizik, **118** çështje të abuzimit seksual dhe **188** çështje të abuzimit emocional; **361** çështje fëmijë dëshmitarë dhune në familje; **532** çështje probleme me mësuesit dhe **350** çështje për probleme akademike. **236** çështje i referohen problemit të bulizmit; **2358** çështjen probleme me bashkëmoshataret; **208** çështje të divorcit të prindërve, **944** çështje probleme të marrdhënieve me prindërit dhe **199** probleme në marrdhëniet vëllazërore; **1158** çështje i referohen kërkesës për informacion në lidhje me substancat psikoaktive dhe **162** çështje në lidhje me mërzitjen dhe depresionin.

ALO 116 flet me fëmijët në momentët më të vështira të jetës së tyre. Parimet kryesore të punës tonë janë:

- ALO 116 është një shërbim falas për të gjithë fëmijët, 24 orë në ditë në 7 ditë të javës;
- Ne këshillojmë dhe informojmë fëmijët për çdo problem që ata kanë;
- Ne referojmë çdo rast, që kërkon zgjidhje, pranë shërbimeve publike dhe private të mbrojtjes së fëmijës;
- Ne luftojmë për të garantuar standardet më të larta dhe më profesionale të ofrimit të shërbimeve për fëmijët dhe të rinjtë;
- Ne besojmë se çdo fëmijë dhe i ri, pavarësisht moshës apo aftësisë, gëzon të drejta të barabarta;
- Ne punojmë që të bëjmë të mundur pjesmarrjen e fëmijëve.

www.crca.al
www.alo116.al

